REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK

Data	Numri	Shtojca
18.03.2019	07 104/02-8154	-/.

KAÇANIKU

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës
Opština Kacanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A:	18. 03. 2019
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSELI, kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Besim ILAZI, kryetar i komunës
NGA/OD/FROM :	Ramadush OSMANI, drejtor i DSHPE-së
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë për Komunën e Kaçanikut 2019-2021

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë **Planin Komunal i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë për Komunën e Kaçanikut 2019-2021,** për shqyrtim në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe procedim të metejmë , si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës së kuvendit komunal.

Me respekt,



Programi IPA i Bashkimit Evropian për Kosovë

Projekti

MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E PAKOS SE 3-të TË ENERGJISË ME FOKUS NË EFIÇIENCËN E ENERGJISË DHE BURIMET E RIPËRTRITSHME

KOMUNA E KAÇANIKUT

Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencën e Energjisë (PKVEE) 2019 – 2021

Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-se ne Kosove

Implementuar nga
GFA Consulting Group GmbH
Ne konzorcium me Exergia S.A dhe AF Mercados

Nëntor 2018

Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë për Komunën e Kaçanikut është përgatitur me mbështetjen e projektit të financuar nga BE-ja "Mbështetja për Zbatimin e Pakos së 3-të të Energjisë me fokus në Efiçiencën e Energjisë dhe Burimet e Ripërtëritshme"

Përgatitur nga:

Arjan Visser, Eksperti kryesor i 2-të - "Mbështetja për Zbatimin e Pakos së 3-të të Energjisë me fokus në Efikasitetin Energjetik dhe Burimet e Ripërtëritshme"

Mbledhja e të dhënave:

Kujtim Asllani, Eksperti Afatshkurtër - " Mbështetja për Zbatimin e Pakos së 3-të të Energjisë me fokus në Efikasitetin Energjetik dhe Burimet e Ripërtëritshme"

Ramadush Osmani, Drejtor i Shërbimeve Publike, Komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut

KAÇANIKU

Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencën e Energjisë (PKVEE)

2019 – 2021

Përmbajtja

1. HYRJE 7
1.1 KONTEKSTI 7
1.2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 9
2. INFORMACIONET BAZË PËR KOMUNËN 10
2.1 POPULLSIA DHE VENDBANIMET 10
2.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE 11
2.3 TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR 11
2.4 PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE PËR EE TË ZBATUARA NË KOMUNË 12
3. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE 13
3.1 KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE 14
3.2 SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK TE RRUGËVE 17
3.3 KOMPANITË PËR SHËRBIME KOMUNALE 17
3.4 TRANSPORTI PUBLIK / PARKU I ATUMOJETEVE TË KOMUNËS 18
4. PRODHIMI I ENERGJISË SË NXEHTËSISË PËR NDËRTESAT PUBLIKE KOMUNALE 18
5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIKASITETIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE 19
5.1 SEKTORI I NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE 19
5.2 SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK TË RRUGËVE 27
5.3 POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË 27
6. PLANI I VEPRIMIT 28
6.1 PROJEKTET INVESTIVE ME PRIORITET KOMUNAL 28
6.2 HAPAT ARDHSHËM 30
7. KORNIZA E FINANCIMIT 31
7.1 PLANIFIKIMET BUXHETORE 31
7.2 FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE) 32
8. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT 32
SHTOJCA 1 – METODOLOGJIA DHE ARSYETIMI 33
SHTOJCA 2 – BURIMI I TË DHËNAVE KOMUNALE 38

Tabelat

Tabela 1: Pasqyra e potencialit te kursimeve te energjisë në Komunën e Kaçanikut 9
Tabela 2: Lista e projekteve për investimet prioritare 10
Tabela 3: Zonat e populluara të komunës së Kaçanikut (2015) 11
Tabela 4: Buxheti i Komunës së Kaçanikut (Euro) 11
Tabela 5: Projektet e EE te zbatuara në 3 vitet e fundit në Komunën e Kaçanikut 12
Tabela 6: Pasqyra e ndërtesave të përjashtuara nga analiza e mëtutjeshme 15
Tabela 7: Konsumi i karburanteve për parkun e automjeteve të komunës (2017) 18
Tabela 8: Pasqyra e potencialit total të kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të komunës 20
Tabela 9: Karakteristikat teknike te ndërtesave administrative 23
Tabela 10: Karakteristikat teknike të ndërtesave arsimore 23
Tabela 11: Karakteristikat teknik e ndërtesave të Mjekësisë familjare 26
Tabela 12: Pasqyra e potencialit total të kursimit të energjisë në sektorin e ndriçimit publik 27
Tabela 13: Potenciali i përgjithshëm i kursimit të energjisë 27
Tabela 14: Projektet investive me prioritet në komunën e Kaçanikut 28
Tabela 15: Investimet e planifikuara me masat EE në buxhetin e Komunës së Kaçanikut (në miliona Euro) 31

Figurat

Figura 1: Shpenzimet komunale për lëndë djegëse dhe energji elektrike, Kaçanikut 2017 12
Figura 2: Përdorimi i lëndëve djegëse në ndërtesat komunale (MWh) 19
Figura 4: Krahasimi i konsumit mesatar specifik të energjisë për ndërtesat komunale të përzgjedhura në komunën e Kaçanikut 22
Figure 5: Paraqitja e projektit investues 1 29
Figure 6: Paraqitja e projektit investues 2 29
Figure 8: Paraqitja e projektit investues 3 30

Shkurtesat

AKEE	-	Agjencia e Kosovës për Efiçiencë të Energjisë
EE	-	Efiçienca e Energjisë
GIZ	-	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
k Euro	-	kilo-Euro (mijëra Euro)
KSE	-	Konsumi Specifik i Energjisë (energjia e përdorur për metër katror në vit)
ktoe	-	*"kiloton oil equivalent"* (kiloton ekuivalent i naftës)
kWh	-	kilovat orë
kWh/m² *v	-	kilovat orë për metër katror në vit (njësi për KSE)
LED	-	Ndriçimi me Dioda Emetuese (teknologjia e ndriçimit efikas të energjisë)
MWh	-	Megavat orë
NA	-	Nuk aplikohet
NI	-	Asnjë informacion (në dispozicion)
PKEE	-	Plani Komunal i Efiçiencës së Energjisë
PKVEE	-	Plani Komunal i Veprimit të Efiçiencës së Energjisë
PNVEE	-	Plani Nacional i Veprimit për Efiçiencën e Energjisë
PVEQ	-	Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme
ZBE	-	Zyra e Bashkimit Evropian

1. HYRJE

Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencën e Energjisë (më tej: PKVEE) i Komunës së Kaçanikut synon që:

- përmes vlerësimit të konsumit të energjisë në Komunën e Kaçanikut, të identifikoj sektorët prioritarë për ndërhyrje me qëllim të rritjes së efiçiencës së energjisë në territorin e saj,
- të vlerësojë potencialin e kursimit të energjisë në komunë dhe të caktojë objektivat për kursimin e energjisë,
- të identifikojë një listë të projekteve prioritarë për investime,
- të identifikojnë modelet e financimit të projekteve,
- të përshkruaj një strukturë institucionale për zhvillimin dhe implementimin e masave të kursimit të energjisë qe do të zbatohen, si dhe monitorimin/raportimin pas implementimit të tyre.

1.1 KONTEKSTI

Bazuar në Direktivën për Efiçiencën e Energjisë 2012/27/BE, që ka hyrë në fuqi më 5 dhjetor 2012, Bashkimi Evropian ka vendosur objektiva për reduktimin e konsumit të energjisë primare në 20% deri në vitin 2020. Republika e Kosovës si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë është përcaktuar të kontribuoj në arritjen e objektivave të efiçiencës së energjisë, duke krijuar stimuj për kursimin e energjisë nga qytetarët, gjithashtu për hapjen e tregjeve dhe bizneseve të reja për aplikimin e teknologjive dhe shërbimeve efikase për energji.

Plani i pare Nacional i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë (2010-2018) u miratua nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më 30 shtator 2011. Ai siguron një objektiv indikativ për arritjen e cakut 9% të 1,021.08 ktoe deri në fund të periudhës së përfshirë me planin (2010-2018). Pra, objektivi mbetet në fuqi deri në vitin 2018 se Kosova duhet të kursej 91.89 ktoe.

Aktivitetet në nivel lokal luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të lartpërmendura në nivel kombëtar.

1.1.1 Kuadri ligjor dhe politik

LIGJI PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË (Ligji Nr. 04 / L-016), miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në qershor 2011 - Neni 9 përshkruan përgjegjësitë e Zyrave Komunale të Energjisë në zhvillimin e Planeve Komunale të Efiçiencës së Energjisë dhe Raporteve të Progresit te Zbatimit të Planit Komunal të Efiçiencës së Energjisë, sipas udhëzimeve të Agjencionit te Kosovës për Efiçiencë të Energjisë-AKEE. Të dy dokumentet duhet të miratohen nga Kuvendi Komunal dhe më pas të dorëzohen në AKEE.

LIGJI PËR ENERGJINË - Neni 4 thotë se Qeveria do të nxjerrë akte nënligjore për themelimin, financimin dhe funksionimin e zyrave komunale të energjisë, të cilat do të adresojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe monitorimin në nivel lokal.

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) Nr. 09/2017, datë 6 shtator 2017, PËR ZYRAT E ENERGJISË KOMUNALE - përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të energjisë për të adresuar

çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave energjetike në nivel lokal. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Zyrave Komunale të Energjisë më poshtë janë shënuar përgjegjësitë kryesore:

- të krijojë një bazë të dhënash dhe të mbajë një sistem informacioni për grumbullimin e rregullt të të dhënave për konsumin e energjisë në baza periodike, shpenzimet e energjisë dhe të dhëna të tjera relevante duke mbajtur një regjistër që mundëson përzgjedhjen e indikatorëve potencial të efiçiencës së energjisë për ndërtesat komunale energjetike,
- të raportojë për zbatimin e PKVEE, dhe zhvillimet e pritshme në pjesën e mbetur të Programit,
- të zhvilloj aktivitetet e planifikimit të sektorit të energjisë, bazuar në Strategjinë e Energjisë, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave,
- të sigurojë të dhënat e nevojshme për Ministrinë përkatëse për përgatitjen e PKVEE-it, rishikimin dhe përgatitjen e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për tre (3) vjet në pajtim me Ligjin për Energjinë,
- të monitorojë vazhdimisht zbatimin e PKVEE në nivelin komunal dhe t'i raportojë Ministrisë për zbatimin e tij.

1.1.2 Objektivat dhe përfitimet nga PKVEE

Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rehatisë dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Kaçanikut.

Në gjendjen e Komunës së Kaçanikut pritet që PKVEE të ketë ndikimet e mëposhtme:

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorët e ndërtimit të ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik;
- Reduktimi i kostove të energjisë në buxhetin komunal;
- Përmirësimi i shërbimeve komunale;
- Renovimet e ndërtesave dhe instalimeve për prodhim të energjisë;
- Përmirësimi i kushteve sanitare dhe nivelit të rehatisë (komfortit) në ndërtesat publike;
- Zvogëlimi i emetimeve të CO_2 në të gjithë sektorët duke zbatuar masat e efiçiencës së energjisë, duke përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke menaxhuar konsumin, përmes trajnimit dhe masave të tjera;
- Ngritja e vetëdijes e kreatorëve të politikave për kursim të energjisë, operatorëve dhe përdoruesve përfundimtarë.

Përfitimet që priten nga zbatimi i PKVEE janë:

- Përfitimet financiare,
- Përfitimet operacionale, duke përfshirë përmirësimin e klimës së brendshme,
- Përfitimet mjedisore.

1.2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PKVEE jep informacion mbi konsumin e energjisë në stokun e ndërtesave komunale - ndërtesat administrative, arsimore dhe shëndetësore si dhe në sektorin e ndriçimit rrugor dhe për flotën komunale dhe kompanitë publike të bazuara në kufijtë e komunës.

Komuna e Kaçanikut ka zbatuar disa projekte të rinovimit me masat EE - përmirësimin e izolimit termik të fasadave të ndërtesave, ndërrimin e dritareve, ndërrimin e ndriçimit publik me LED.

Analiza e stokut të ndërtesave komunale dhe shërbimeve të ndriçimit rrugor tregon se potenciali i përgjithshëm i kursimeve të energjisë në Komunën e Kaçanikut është vlerësuar të jetë 5,454 MWh në vit.

Tabela 1: Pasqyra e potencialit të kursimeve të energjisë në Komunën e Kaçanikut

	Konsumi i energjisë (2017) MWh/vit	Shpenzimet e konsumit të energjisë (2017)	Potenciali për kursim MWh/vit	Potenciali për kursim %
Sektori i Ndërtesave Komunale	4,713[1]	€ 127,516	2,194[2]	52%[3]
Sektori i Ndriçimit Rrugor	230	€ 18,429	60[4]	50%[5]
Flota Komunale e Automjeteve	230	€ 36,043	-	-
Kompanitë Publike në Komunë	NA	NA	-	-
Gjithsej	**5,454**	**€ 181,988**	**2,254**	

Një listë prioritare e projekteve të investimeve përfshin **3** projekte me një kursim të përgjithshëm të energjisë prej **417** MWh /vit dhe investime që kushtojnë së paku € 388,000, kërkojnë elaborim të mëtejshëm, edhe pse këto janë paraqitur në Pjesën e Veprimit të këtij PKVEE.

[1] Për të gjitha ndërtesat komunale të raportuara

[2] Kursimi për ndërtesat komunale të përfshira në analizë (d.m.th. me sipërfaqe dhe konsum të energjisë njohur dhe mbi 80 kWh/m2*a)

[3] Përqindja e kursimeve vetëm për ndërtesat komunale të përfshira në analizë

[4] Për pjesën e mbetur të ndriçimit publik që ende nuk ka teknologji LED

[5] Krahasuar me konsumin e energjisë së ndriçimit rrugorë që është raportuar se është pa teknologji LED

Tabela 2: Lista e projekteve per investimet prioritare[6]

#	Emri i objektit	Lloji	Konsumi (2017) MWh/vit	Potenciali i kursimeve MWh/vit %	Investimet k Euro
1	Shfmu 'Emin Duraku'- Kaçanik	Arsim	423	161	228-325
2	Shfmu 'Idriz Seferi' - Bob	Arsim	188	137	45-64
3	Shfmu 'Kadri Zeka' – Dubravë	Arsim	225	119	92-132
GJITHËSEJ:			**8366**	**417**	**388-544**

Për të tri ndërtesat të invistemeve prioritare konsumi specifik i energjisë është mjaft i lartë në bazë të asaj që hapësirë e këtyre ndërtesave është mjaft e madhe si pasoj kursimet absolute të energjisë dhe kursimi në shpenzimet komunale janë mjaft të konsiderueshme.

Vini re se të dhënat e raportuara janë vetëm vlerësimet e para dhe prandaj duhet të kontrollohen dhe detajohen gjatë një auditimi të energjisë. Nëse të dhënat vërtetohen të jenë valide, atëherë për këto projekte mund të marrin masat të energjisë së rinovueshme dhe mund të përpunohen në auditimin përkatës të energjisë si dhe në planin investiv.

2. INFORMACIONET BAZË PËR KOMUNËN

Kaçanik (shqip: Kaçanik ose Kaçaniku serb: Kačanik) është një qyteze dhe komunë që ndodhet në rajonin e Ferizajt në Kosovë.

2.1 POPULLSIA DHE VENDBANIMET

Sipas regjistrimit te popullsisë te vitit 2011, Kaçaniku ka një numër prej 33,409 banorëve. Ka sipërfaqe prej 220 km^2, dhe përbehet nga një qytezë dhe 31 fshatra (Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2011).

[6] Te dhenat ne kete tabele jane plotesuar nga Komuna e Kaçanikut, prandaj kjo tabele dallon nga tabela me perllogaritjet e bera nga Projekti "Mbeshtetje ne Implementimin e pakos se 3-te" i financuar nga BE. Pergjegjesine per saktesine e te dhenave ne kete tabele e mbane Komuna e Kaçanikut.

Tabela 3: Zonat e populluara te komunës se Kaçanikut (2015)

Zonat e populluara	Numri i banorëve
220 km²	33,409
Qyteti i Kaçanikut	10,393

Burimi – Regjistrimi i Popullsise 2011

2.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE

Komuna e Kaçanikut nuk ka emëruar ende një Menaxher të Energjisë. Të dhënat në këtë dokument janë siguruar nga z. Ramadush Osmani

2.3 TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR

Kaçaniku ka një traditë të vjetër në prodhimin e gurit gëlqeror, drurit për qëllime ndërtimi dhe shërbime të tjera dhe shkathtësi artizanale.

Pjesa e mbetur e forcës punëtore zhvillon biznes privat ose punon në sektorin bujqësor.

Tabela 4: Buxheti i Komunës së Kaçanikut (Euro)

Kaçanik	2016
Buxheti total	**€ 6,631,000**
Fatura e përgjithshme e energjisë	**€ 181,988**
Ndërtesat publike – (përfsh. Ene. elektrike)	€ 127,516
Ndriçimi publik	€ 18,429
Automjetet e komunës (karburantet)	€ 36,043
Investimet TOTALE për masat e EE	€ 191,365
Kontributi i drejtpërdrejt nga buxheti i Komunës	€ PM

Burimi i informatave – komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut ka shpenzuar afërsisht 2,7% të buxhetit të saj për të mbuluar kostot e energjisë. Shpenzimet llogariten duke përdorur konsumin e energjisë të raportuar nga komuna dhe çmimet mesatare specifike të karburanteve dhe energjisë elektrike.

Shpenzimet komunale për lëndë djegëse, karburante dhe energji elektrike për vitin e kaluar raportues mund të gjenden në grafikun e mëposhtëm.



Figura 1: Shpenzimet komunale për lëndë djegëse dhe energji elektrike, Kaçanikut 2017

2.4 PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE PËR EE TË ZBATUARA NË KOMUNË

Të dhënat janë të disponueshme për një projekt në lidhje me efikasitetin energjetik që është zbatuar në tri vitet e fundit, një numër i projekteve renovuese kanë ndodhur dhe një pjesë e ndriçimit publik janë zëvendësuar dhe tani janë të teknologjisë LED.

Tabela 5: Projektet e EE te zbatuara ne 3 vitet e fundit ne Komunen e Kaçanikut[7]

Objekti	Masat/viti e zbatuara për EE	Vlera financiare totale	Kursimet e arritura të energjisë	Komentet
SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"	Izolimi i mbështjellësit të ndërtesës, duke zëvendësuar dritaret, çatinë / 2,962 m2	Eur 195,000	NI	2012

[7] Tabela eshte plotesuar nga Komuna e Kacanikut pas dorezimit te Draftit te PKVEE-se nga Projekti "Mbeshtetje ne Implementimin e pakos se 3-te" i financuar nga BE

Gjimnazi "Skenderbeu"- Kaçanik	Renovimi i gjimnazit "Skenderbeu" duke përfshirë izolimin, dritaret, ndërrimi i pullazit	Eur 156,000	NI	2018
Paralelja e SHFMU "Idriz Seferi" në fshatin Gajre	Renovimi i objektit duke përfshirë izolimin, dritaret, ndërrimi i pullazit	Eur 62,000	NI	2018
Paralelja e SHFMU "Kadri Zeka" në Provoli	Ndërrimi i dyerve dhe dritareve	Eur 5,800	NI	2018
Paralelja e SHFMU "Jusuf Gervalla" në fshatin Nikaj	Renovimi i shkollës duke përfshirë ndërrimin e pullazit	Eur 15,800	NI	2018
Ndërtesa e Administratës së Komunës	Nderrimi i poqave ndriçues në ndërtesën e Komunës së Kaçanikut	Eur 9,728	NI	2018
Ndriçimi publik	Zëvendësimi i llampave ndriçuese me LED. Gjithsejt 440 llampa të zëvendesuara	Eur 13,276	NI	2018
QEAP "Agimi"-Kaçanik	Ndërrimi i bojlerit (por është ruajtur lëndë djegese fosile e lëngshme)	Eur 1,900	NI	2016
Shfmu "Agim Bajrami" -Stagove	Izolimi i mbeshtjellesit të ndërtesës, zëvendësimi i dritareve, dhe bojler i ri i biomasës	Eur 178,000	NI	2016
Shfmu"Jusuf Gërvalla" - Biçec	Instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore me djegie të biomasës	Eur 11,465	NI	2016
Ndriçimi publik në rrugën "Vëllezërit Çaka"	8 llampa zëvendësohet me LED	Eur 4,460	NI	2017

Burimi i informacionit - AKEE Mars 2018 për projektet e LED dhe rinovimit

3. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të energjisë në ndërtesat publike të Komunës së Kaçanikut u siguruan nga personi kontaktues[8]. Të dhënat e siguruara nga komuna konsiderohen mjaft të plota.

[8] z. Ramadush Osmani

3.1 KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE

Analiza e të dhënave për konsum specifik të energjisë të ndërtesave tregon se konsumi i energjisë i raportuar në të gjitha ndërtesat publike komunale luhatet nga vlera minimale prej 1 kWh/m^2 në vit deri në 609 kWh/m^2 në vit.
Në mënyrë që të kemi një analizë të fortë të stokut të ndërtesave, ndërtesat do të përjashtohen për analiza të mëtejshme në bazë të tre treguesve të mëposhtëm:

1. Ndërtesat për të cilat nuk janë ofruar informacione për sipërfaqen e përgjithshme që ngrohet;
2. Ndërtesat me vlera të ulëta të konsumit specifik të energjisë, më pak se 80 kWh/m^2, të cilat do të tregonin se ndërtesa të tilla tashmë ishin mjaft efikase për energji;
3. Ndërtesat me vlera shumë të larta të konsumit të energjisë, më shumë se 400 kWh/m^2, të cilat mund të tregojnë se të dhënat janë të pasakta (gabimet në të dhëna). Së pari duhet të hetohen të dhënat e disponueshme të konsumit të energjisë të këtyre ndërtesave.

Tabela 6: Pasqyra e ndërtesave të përjashtuara nga analiza e mëtejshme

Pjesa A: Lista e ndërtesave për të cilat nuk janë ofruar të dhëna për hapësirën totale / ngrohëse dhe / ose konsumin e karburantit për prodhimin e ngrohjes (për vitin 2016):

1. Qeveria – Mirëqenie Sociale – Zyra komunale për punësim

Pjesa B: Lista e ndërtesave për të cilat konsumi specifik i energjisë është shumë i ulët:

Nen 50 kWh/m^2*vit:

1.	Edukim - Shkolla fillore e mesme e ulët	"Emin Duraku"- Dushkajë
2.	Kulturë -Shtëpia e kulturës	"Xheladin Kurtaj"-Kaçanik
3.	Kulturë -Shtëpia e kulturës	Globoçicë
4.	Shëndetësi – Ambulancë	Bob
5.	Shëndetësi – Ambulancë	Biqec
6.	Shëndetësi – Ambulancë	Stagovë
7.	Shëndetësi – Ambulancë	Kaçaniku i Vjetër
8.	Shëndetësi – Ambulancë	Begracë
9.	Shëndetësi – Ambulancë	Elezaj
10.	Shëndetësi – Ambulancë	Ivajë
11.	Shëndetësi – Ambulancë	Shtrazë
12.	Shëndetësi – Ambulancë	Glloboqicë
13.	Shëndetësi – Ambulancë	Dubravë

Në mes të 50-80 kWh/ m^2*vit:

14.	Edukim	Shkollë fillore e mesme e ulët	"7 Shtatori" Begracë
15.	Edukim	Shkollë fillore e mesme e ulët	"Emin Duraku" Kërbliq
16.	Edukim	Shkollë fillore e mesme e ulët	"Ditura" Shtrazë
17.	Shëndetësi	Ambulancë	Kotlinë
18.	Qeveria – Zjarrëfikësat - Shërbimi i Zjarrfikësave dhe Shpëtimit		
19.	Qeveria – Mireqenie Sociale – Qendra për punë sociale		

Pjesa C: Lista e ndërtesave për të cilat konsumi specifik i energjisë është shumë i lartë

1.	Administrata	Komuna	Zyra e Vendit- Ivajë

Në total, 21 ndërtesa janë përjashtuar nga analiza e mëtejshme për shkak të konsumit specifik të energjisë që është jashtë brezit (19 ndërtesa nën 80 kWh / m2 * në vit, 1 ndërtesë mbi 400 kWh / m2 * në vit), dhe 1 ndërtesë nuk është përfshirë pasiqë nuk ka të dhëna për sipërfaqen. Shikoni arsyetimin për këtë metodologji në shtojcën 2 të këtij dokumenti.

Prandaj, nëse përqëndrohemi në potencialin e efiçencës së energjisë, gjithsej 34 nga 55 ndërtesa ose 62% e stokut të ndërtesave në Kaçanik ka gjasa të sigurojnë kursime të mira ose madje të konsiderueshme të energjisë.

I. Fokusimi në ndërtesat me konsum specifik të energjisë (KSE) midis 80 dhe 400 kWh / m^2 * vit. Shifra të tilla të konsumit janë tejet të larta
II. Ndërtesat me KSE nën 80 kWh / m^2 * vit janë tashmë shumë efikase. Masat e efikasitetit të energjisë për të reduktuar konsumin e energjisë janë relativisht të shtrenjta. Një opsion për këtë kategori të ndërtesave do të ishte marrja në konsideratë e zbatimit të masave të energjisë së rinovueshme.
III. Kontrollimi dhe verifikimi për gabimet statistikore dhe / ose faturat me gabime të energjisë, kontrollimi për gabime në llogaritjen e konsumit të karburantit për ndërtesat me KSE mbi 400 kWh / m^2.
IV. Kontrolli për të dhëna korrekte për siperfaqen për ndërtesat që nuk kanë të dhëna të tilla (këto ndërtesa nuk do të vlerësohen në këtë metodologji)

Duke marrë parasysh këtë, për nevojat e analizës së konsumit të energjisë, stoku i ndërtesave në pronësi të Komunës së Kaçanikut ndahet në 4 kategoritë e mëposhtme:

- Ndërtesa administrative,
- Ndërtesa arsimore,
- Ndërtesat e kujdesit të mjekësisë familjare,
- Ndërtesa kulturore dhe sportive.

Ndarja e stokut të ndërtesave komunale në kategoritë e lartpërmendura është bërë me qëllim që të merret njohuria më e saktë e konsumit aktual të energjisë termike dhe elektrike në nën sektorin e ndërtesave në pronësi të Komunës së Kaçanikut.

3.1.1 Ndërtesat administrative

Duke u bazuar në kriteret tona përzgjedhëse, janë 5 **ndërtesa administrative** të raportuara nga Komuna e Kaçanikut me një sipërfaqe totale ngrohese prej **998 m^2**.

Konsumi total i raportuar i energjisë në këto ndërtesa administrative të Komunës së Kaçanikut në vitin 2016 ishte **235** kWh/m^2

Analiza e të dhënave tregon se konsumi mesatar i energjisë specifike për ndërtesat e përzgjedhura administrative është 235 kWh/m^2.

3.1.2 Ndërtesat arsimore

Jane 27 ndërtesa arsimore të përzgjedhura në Komunën e Kaçanikut me një sipërfaqe totale ngrohëse prej 19,747 m^2 të ndara në tri kategori:

- Kopshti i fëmijëve / parashkollor - 2 ndërtesa, sipërfaqja e përgjithshme 482 m^2
- Shkollat fillore e mesme e ulët -23 ndërtesa, sipërfaqja 13,957 m^2
- Shkollat e mesme - 2 ndërtesa, sipërfaqe totale 5,308 m^2

Konsumi i përgjithshëm (i raportuar) i energjisë në ndërtesat nën-sektoriale të arsimit të Komunës së Kaçanikut në vitin 2016 ishte 3,467 MWh, që jep konsumin specifik prej 176 kWh / m^2.

Analiza e të dhënave tregon se, konsumi specifik i përgjithshëm i energjisë luhatet nga 102 kWh/m^2 deri në 388 kWh/m^2 *vit

3.1.3 Ndërtesat shëndetësore

Ekzistojnë **2** ndërtesa të kujdesit shëndetësor në Komunën e Kaçanikut me një sipërfaqe totale për ngrohje prej **4,504** m^2.

Konsumi i energjisë për këtë përzgjedhje të ndërtesave të kujdesit shëndetësor të Komunës së Kaçanikut në vitin 2016, ishte **512** MWh.

Analiza e të dhënave tregon se konsumi mesatar specifik i energjisë është 114 kWh/m^2.

3.1.4 Ndërtesat e kulturës dhe sportit

Nuk ka ndërtesa kulturore dhe/ose objekte sportive të raportuara nga Komuna e Kaçanikut e cila ofron mundësi për të kursyer energji.

3.2 SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e ndriçimit publik të Komunës së Kaçanikut u bënë direkt nga komuna.

Gjatësia totale e rrjetit të ndriçimit publik është raportuar të jetë **11.6 kilometra**. Ndriçimi i rrugëve është siguruar për **30 rrugë/seksione** në Komunën e Kaçanikut.

Rrjeti elektrik i ndriçimit publik në Komunën e Kaçanikut përfshin 477 ndriçues. Nga kjo total, 75% janë raportuar të jenë të teknologjisë së dritës fluoreshente kompakte (CFL), pjesa tjetër e mbetur drita inkandeshente (15%) dhe LED (10%).

Konsumi i energjisë elektrike i sistemit të ndriçimit publik në vitin 2016 është raportuar të jetë rreth 230 MWh. Konsumi mund të jetë më i ulët për 2018 dhe mund të ulet edhe më tej nëse llampat CFL dhe llampat inkandashente zëvendësohen me teknologjinë LED.

3.3 KOMPANITË PËR SHËRBIME KOMUNALE

Komuna e Kaçanikut ka raportuar 3 kompani dhe struktura në pronësi të komunës. Këto tri (3) kompani përbëhen nga tre objekte ndërtimi mjaft të vogla.

Në ato raste ku vlerësohet e përshtateshme, rekomandohet që të aplikohen masat e efikasitetit të energjisë (dritare të dyfishta, izolim) kur buxheti i mirëmbajtjes është i disponueshëm për këto struktura.

3.4 TRANSPORTI PUBLIK / FLOTA ATUMOJETEVE TË KOMUNËS

Komuna e Kaçanikut **nuk ofron shërbime publike të transportit** dhe prandaj vetëm analiza e flotës së automjeteve të Komunës së Kaçanikut.

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të karburantit në flotën komunale janë mbledhur nga administrata e Komunës së Kaçanikut.

Flota e automjetëve në pronësi të Komunës së Kaçanikut përfshin 31 automjete të përdorura nga komuna.

Konsumi total i karburantit i flotës komunale në vitin 2016 ishte rreth. 36,000 (litër).

Tabela 7: Konsumi i karburanteve për parkun e automjeteve të komunës (2017)

Lloji i karburantit	Numri i automjeteve	Konsumi Litra
Dizel/nafte	30	35,343
Benzinë	1	700
Gjithsej	**31**	**36,043**

Burimi i informatave – Komuna e Kaçanikut

Në përgjithësi, përveç emetimeve të karbonit, automjetet me karburant dizel tani njihen të kontribuojnë ndjeshëm në përkeqësimin e cilësisë së ajrit në zonat urbane sidomos (emetimet e grimcave PM10)

4. PRODHIMI I ENERGJISË SË NGROHESE PËR NDËRTESAT PUBLIKE KOMUNALE

Janë gjithsej **55 ndërtesa publike komunale** në nën sektorin e ndërtesave në pronësi të Komunës së Kaçanikut të përfshira në analizë, me një sipërfaqe totale ngrohese prej **93,342 m²**. Bazuar në të dhënat e komunës, këto ndërtesa në vitin 2016 konsumuan këto burime te energjise ne vijim:

- **20 ton** qymyr
- **1,917 m³** dru
- **50 ton** pelet druri
- **23,000 litra** naftë për prodhimin e nxehtësisë
- **Nuk ka shërbime të ngrohtorës së qytetzës**

Duke përfshirë energjinë elektrike (110 MWh në vitin 2016) e cila gjithashtu mund të përdoret për ndriçim dhe pajisje elektrike), lënda djegëse më e rëndësishme që është përdorë për ndërtesat

komunale në Kaçanik është druri, me një pjesëmarrje rreth 75%, e pasuar nga qymyri me 13% ndërsa energjia elektrike, peleti dhe derivatet e naftës kane përqindje me te vogël. Shih gjithashtu grafikun më poshtë.



Figura 2: Përdorimi i lëndëve djegëse në ndërtesat komunale (MWh)

5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIKASITETIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Vlerësimi i potencialit të efiçiencës së energjisë është bërë në dy sektorë kryesorë që janë nën kontrollin e plotë të Komunës së Kaçanikut - sektori i ndërtesave publike komunale dhe sektori i ndriçimit publik.

5.1 SEKTORI I NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE

Vlerësimi i potencialit të efikasitetit energjetik të ndërtesave me konsum specifik të energjisë nga 50 dhe 400 kWh/m^2, janë marr në konsideratë për zbatimin e masave të EE. (Shih shpjegimet më mësipërme). Në tërësi ka **34** ndërtesa publike komunale me një konsum te tillë specifik të energjisë në Komunën e Kaçanikut (nga **55** të përfshira në analizë), me një potencial total të kursimit për këto 34 ndërtesa komunale prej 2,194 MWh në vit, me potencial mesatar të kursimit 52%.

Tabela 8: Pasqyra e potencialit total te kursimit te energjise ne stokun e ndertesave te komunes

Nr	Lloji i Nderteses	Ndërtesa	Sipërfaqja që ngrohet m^2	Konsumi specifik i energjisë kWh/m^2	Vlera e cakut kWh/m^2	Potenciali i kursimit të energjisë kWh/vit
1	Shkolle e mesme	Gjimnazi "Skenderbeu "Kaçanik[9]	102	80	2,346	52,115
2	Shkolle e mesme Profesionale	"Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"	166	80	2,962	255,971
3	Shkolle Fillore	"Emin Duraku" Kaçanik Meter 1	130	80	3,254	161,879
4	Shkolle Fillore	"Idriz Seferi" Bob	291	80	646	136,399
5	Shkolle Fillore	"Jusuf Gervalla" Biçec	175	80	960	91,178
6	Shkolle Fillore	"Kadri Zeka" Dubravë	170	80	1,324	119,501
7	Shkolle Fillore	"Qamil Ilazi" Kaçanik i Vjetër[10]	250	80	750	127,717
8	Shkolle Fillore	"Ali Asllani" Doganaj	199	80	948	113,074
9	Shkolle Fillore	"Agim Bajrami" Stagovë[11]	169	80	800	71,058
10	Shkolle Fillore	"Dituria" Ivajë Meter 1	273	80	407	78,373
11	Shkolle Fillore	"Avdylgafurr Luma" Glloboqice[12]	222	80	500	71,136
12	Shkolle Fillore	"Naim Frashëri" Meter 1	231	80	400	60,277
13	Shkolle Fillore	"Nazmi Osmani" Elezaj	300	80	750	165,043
14	Shkolle Fillore	"Jusuf Gervalla" Nikaj[13]	157	80	548	42,406

[9] E renovuar me masa EE gjate vitit 2018
[10] Ne procedure tenderimi/ndertimi te objektit te ri
[11] Ne procedure tenderimi/ndertimi te objektit te ri
[12] Ne procedure tenderimi/ndertimi te objektit te ri
[13] E renovuar me masa EE gjate vitit 2018

Nr	Lloji i Nderteses	Ndërtesa	Sipërfaqja që ngrohet m^2	Konsumi specifik i energjisë kWh/m^2	Vlera e cakut kWh/m^2	Potenciali i kursimit të energjisë kWh/vit
15	Shkolle Fillore	"Kadri Zeka" Vataj	370	80	200	58,065
16	Shkolle Fillore	"Kadri Zeka" Provoli[14]	194	80	100	11,362
17	Shkolle Fillore	"Nazmi Osmani" Bajnicë	388	80	215	66,118
18	Shkolle Fillore	"Ali Asllani " Sllatinë	153	80	120	8,798
19	Shkolle Fillore	"Ali Asllani" Koxhaj	110	80	168	5,043
21	Shkolle Fillore	"Emin Duraku" Gjurgjedell	107	80	352	9,355
22	Shkolle Fillore	"Emin Duraku" Llanishtë	113	80	82	2,701
23	Shkolle Fillore	"Emin Duraku" Runjevë	113	80	333	10,864
24	Shkolle Fillore	"Idriz Seferi" Gajre	294	80	253	54,169
25	Shkolle Fillore	"Idriz Seferi" Kovaqec[15]	303	80	217	48,482
26	Shkolle Fillore	"Qamil Ilazi"Fushë e Pajtimit	125	80	630	28,133
27	Institucion parashkollorë	QEAP "Agimi"[16]	158	80	420	32,898
28	Qerdhe	DKA Gajre[17]	169	80	62	5,518
29	Administrate	Zyre e vendit,Gllobocice	307	80	30	6,799
30	Shëndetesi	"Dëshmoret e Lirisë"	114	80	4,500	151,930
31	Shëndetesi	AF Doganaj	96	80	4	63
32	Administratë	Ndërtesa eK.Kacanik	233	80	878	134,638

[14] E renovuar me masa EE gjate vitit 2018
[15] Ne procedure tenderimi/ndertimi te objektit te ri
[16] Ne procedure tenderimi/ndertimi te objektit te ri
[17] E renovuar me masa EE gjate vitit 2018

Nr	Lloji i Nderteses	Ndërtesa	Sipërfaqja që ngrohet m^2	Konsumi specifik i energjisë kWh/m^2	Vlera e cakut kWh/m^2	Potenciali i kursimit të energjisë kWh/vit
33	Administratë	Zyre e vendit - Kacanik i Vjeter	135	80	8	438
34	Administratë	Zyrë e vendit- Dubravë	317	80	30	7,121

Struktura e konsumit total të energjisë sipas kategorive të ndërtesave në pronësi të Komunës së Kaçanikut është paraqitur në figurën tjetër.



Figura 3: Krahasimi i konsumit mesatar specifik të energjisë për ndërtesat komunale të përzgjedhura në komunën e Kaçanikut

Nga krahasimi i konsumit specifik të energjisë, është e qartë se ekzistojnë dallime në mes të kategorive të ndryshme, kështu që rekomandimi është që të fillohet të bëhen auditimet e energjisë në ndërtesat me konsumin më të lartë të energjisë. (Në këtë raste: ndërtesat administrative).

Kriteret e përdorura për përzgjedhjen e ndërtesave prioritare për investime janë si më poshtë:

- Potenciali më i lartë i kursimit të energjisë,
- Qëndrueshmëria e investimeve - ndërtimi do të përdoret së paku për 10 vitet e ardhshme,
- E kanë të kryer auditimin e energjisë,
- Kanë potencial të mirë për implementimin e masave të EE.

Nga grupi i **(34)** ndërtesave të paracaktuara për rinovim, ne ofrojmë karakteristika themelore teknike për të përgatitur (më tej) përmirësimin e performancës së energjisë.

5.1.1 Ndërtesat administrative

Tabela 9: Karakteristikat teknike te ndërtesave administrative

#	Ndërtesa	Viti i ndërtimit	Izolimi termik i ndërtesës fasada/viti	Xhamat e dyfishtë ne dritare/viti	Auditimi i energjisë	Konsumi specifik i nxehtësisë kWh/m²
1	Zyra e Vendit-Glloboqicë	2008	Po (2008)	Po (2008)	Po	307
2	Ndërtesa e administratës komunale	1986	Jo	Po (2013)	Po	233
3	Zyra e Vendit-Kaçanik i Vjetër	2012	Po (2012)	Po (2012)	Po	135
4	Zyra e Vendit-Dubravë	2004	Jo	Po (2004)	Po	317
5	Zyra e Vendit-Doganaj	2008	Po (2008)	Po (2008)	Po	191

Burimi i informatave – Zyra e Vendit *komuna Kaçanik*

Vlera e saktë e kursimeve nga masat dhe kthimi i investimeve duhet të përcaktohen sipas auditimit të energjisë i cili duhet te behet.

5.1.2 Ndërtesat arsimore

Tabela 10: Karakteristikat teknike te ndërtesave arsimore

#	Ndërtesa	Viti i ndërtimit	Izolimi termik i ndërtesës fasada/viti	Xhamat e dyfishtë ne dritare/viti	Auditimi i energjisë	Konsumi specifik i nxehtësisë kWh/m²
1	Shm "Skenderbeu"	1972	Jo	NI	Jo	102
2	Shm profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"	1980	Po	2014	Jo	166
3	Shfm e ulët "Emin Duraku" Njehsori 1	1952	Jo	NI	Jo	130
4	Shfm e ulët "Idriz Seferi" Bob	1980	Jo	NI	Jo	291
5	"Shfm e ulët "Jusuf Gërvalla" Biçec	1983	Jo	NI	Jo	175

#	Ndërtesa	Viti i ndërtimit	Izolimi termik i ndërtesës fasada/viti	Xhamat e dyfishtë ne dritare/viti	Auditimi i energjisë	Konsumi specifik i nxehtësisë kWh/m²
6	Shfm e ulët "Kadri Zeka" Dubravë	1981	Jo	NI	Jo	170
7	Shfm e ulët "Qamil Ilazi" Kaçanik i Vjetër	1965	Jo	NI	Jo	250
8	Shfm e ulët "Ali Asllani" Doganaj	1939	Jo	NI	Jo	199
9	Shfm e ulët "Agim Bajrami"	2017	Po	2017	Jo	169
10	Shfm e ulët "Dituria Ivajë" Njehsori 1	1972	Jo	NI	Jo	273
11	Shfm e ulët "Avdylgafurr Luma" Glloboqice	1969	Jo	NI	Jo	222
12	Shfm e ulet "Naim Frashëri" Njehsori 1	1999	Jo	NI	Jo	231
13	Shfm e ulët "Nazmi Osmani" Elezaj	1988	Jo	NI	Jo	300
14	Shfm e ulët "Jusuf Gërvalla" Nikaj	1973	Jo	NI	Jo	157
15	Shfm e ulët "Kadri Zeka" Vataj	2011	Po	NI	Jo	370
16	Shfm e ulët "Kadri Zeka" Provoli	1981	Jo	NI	Jo	194
17	Shfm e ulët "Nazmi Osmani" Bajnicë	1984	Jo	NI	Jo	388
18	Shfm e ulët "Ali Asllani" Sllatinë	2001	Jo	NI	Jo	153
19	Shfm e ulët "Ali Asllani" Koxhaj	2002	Jo	NI	Jo	110
20	Shfm e ulët "Emin Duraku" Gjurgjedell	1983	Jo	NI	Jo	107
21	Shfm e ulët "Emin Duraku" Llanishtë	1983	Jo	NI	Jo	113

#	Ndërtesa	Viti i ndërtimit	Izolimi termik i ndërtesës fasada/viti	Xhamat e dyfishtë ne dritare/viti	Auditimi i energjisë	Konsumi specifik i nxehtësisë kWh/m²
22	Shfm e ulët "Emin Duraku" Runjevë	1983	Jo	NI	Jo	113
23	Shfm e ulët "Idriz Seferi" Gajre	1974	Jo	NI	Jo	294
24	Shfm e ulët "Idriz Seferi" Kovaqec	1974	Jo	NI	Jo	303
25	Shfm e ulët "Qamil Ilazi" Fushe e Pajtimit	2002	Po	NI	Jo	125
26	Parashkollor QEAP Agimi	1982	Jo	NI	Jo	158
27	Qerdhe DKA Gajre	1972	Jo	NI	Jo	169

Burimi i informatave – komuna e Kaçanikut

Vlera e saktë e kursimeve nga masat dhe kthimi i investimeve duhet të përcaktohet bazuar në auditimet e kryera të energjisë.

5.1.3 Ndërtesat e kujdesit të mjekësisë familjare

Tabela 11: Karakteristikat teknik e ndërtesave të Mjekësisë familjare

#	Ndërtesa	Viti i ndërtimit	Izolimi termik i ndërtesës fasada/viti	Xhamat e dyfishtë ne dritare/viti	Auditimi i energjisë	Konsumi specifik i nxehtësisë kWh/m²
1	QKMF Dëshmoret e Lirisë	2015	Po (2015)	Po (2015)	Po	114
2	Ambulanca "AF Doganaj"	2000	jo	jo	Po	96

Burimi i informatave – Komuna e Kaçanikut

Vlera e saktë e kursimeve nga masat dhe kthimi i investimeve duhet të përcaktohet duke u bazuar në kryerjen e auditimeve të energjisë.

5.1.4 Ndërtesat e kulturës dhe sportit

Nuk ka objekte në këtë kategori sipas kritereve tona të përzgjedhjes.

5.2 SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK TË RRUGËVE

Gjatë vitit 2018 komuna ka investuar duke zëvendësuar me LED 440 llamba nga gjithësej 477, për vitin 2019 mbetet të zëvendësohen 37 llamba(parmasa si dhe mjetet e nevojshme për zëvendësimin e tyre tashmë jan ndarë nga komuna, dhe në afatin sa më të shkurtë pritet fillimi i projektit për zëvendësimin e tyre).

